



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u mbështetur në nenin 7, paragrafi 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 39, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, në mbledhjen e mbajtur më datën 05.09.2019, miraton këtë:

RREGULLORE NR.07/2019

PËR CERTIFIKIMIN E INTERPRETËVE DHE PËRKTHYESVE GJYQËSORË

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores

1. Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat e certifikimit dhe emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes dhe interpret gjyqësor, lartësia e shpërblimit për punën e tyre, si dhe largimi nga regjistri.
2. Objekt i kësaj rregulloreje janë vetëm përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë të cilët aplikojnë dhe certifikohen nga KGJK si përkthyes dhe/apo interpret gjyqësor.

Neni 2

Parimet e përgjithshme

Kjo rregullore zbatohet në pajtim me parimet e mos-diskriminimit, trajtimit të barabartë, përfaqësimit gjinor dhe etnik.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Në këtë Rregullore, shprehjet e mëposhtme kanë këtë kuptim:
 - 1.1. çift i gjuhëve - nënkupton dy gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës, ose një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës dhe një gjuhë e huaj, si dhe nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën, si dhe anasjelltas.
 - 1.2. interpret gjyqësor- është çdo individ i certifikuar sipas kësaj Rregulloreje që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të interpretimit në një procedurë gjyqësore, ose në rastet kur interpretimi është i nevojshëm për zhvillimin e procedurës gjyqësore;
 - 1.3. përkthyes gjyqësor- është çdo individ i emëruar sipas kësaj Rregulloreje që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të përkthimit të dokumenteve të shkruara gjyqësore dhe jo gjyqësore;
 - 1.4. përvojë e punës - në kuptim të kësaj Rregulloreje është përvoja në përkthim përfshirë sektorin privat, publik si dhe në organizata vendore dhe ndërkombëtare;
 - 1.5. ditët - nënkuptojnë ditët kalendarike, dhe
 - 1.6. profesionist i gjuhës- është personi i cili ka përvojë dhe njohje të mirë të çiftit të gjuhëve.

Neni 4 **Shpallja e konkursit**

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK) shpall konkursin për certifikim të përkthyesve/ interpretëve gjyqësorë në ueb faqen zyrtare të KGJK-së dhe në një apo më tepër gazeta ditore apo mjete tjera të informimit brenda territorit të Republikës së Kosovës.
2. Konkursi publikohet në një afat jo më të gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.
3. KGJK vendos për kohën e shpalljes së konkursit për çifte gjuhësh, varësisht prej nevojës dhe kërkesës.

Neni 5 **Kriteret**

1. Për t'u certifikuar si interpret/përkthyes, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte të përgjithshme:
 - 1.1. të jetë shtetas i Kosovës;
 - 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - 1.3. të ketë diplomë universitare;

- 1.4. të mos jetë i dënuar për veprë penale, në përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.5. të ketë së paku dy (2) vjet përvojë pune si interpret ose përkthyes.

Neni 6

Aplikacioni për certifikim

1. Aplikacioni për certifikim i dorëzohet KGJK-së, sipas formularit të hartuar nga Sekretariati i KGJK-së, duke ia bashkëngjitur dokumentet e vërtetuara me të cilat dëshmon se i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.
2. Aplikacioni i kandidatit duhet të jetë i qartë: ai kërkon të certifikohet si përkthyes gjyqësor apo si përkthyes dhe interpret gjyqësor.
3. Kandidati në aplikacion cakton çiftin e gjuhëve për të cilën kërkon të certifikohet.
4. Kandidati mund të aplikojë për certifikim për më shumë se një çift gjuhësh.
5. Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si përkthyes gjyqësor për një çift gjuhësh duhet të paguajë taksën prej 70€, ndërsa kandidati i cili aplikon për përkthyes dhe interpret gjyqësor për një çift gjuhësh, paguan shumën prej 100€.
6. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 5 të kësaj rregulloreje detyrohen të bëjnë pagesën e lartcekur para nënshtrimit të procesit të testimit. Kandidatët që nuk e kryejnë pagesën brenda afatit të paraparë nuk do t'i nënshtrohen procesit të testimit.

Neni 7

Organizimi dhe mbajtja e provimit

1. KGJK i kryen të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e provimit përfshirë këtu edhe hartimin e aplikacionit dhe format tjera të nevojshme.
2. KGJK e formon Komisionin për vlerësimin dhe testimin e kandidatëve (tutje: Komisioni), siç parashihet në nenin 8 të kësaj rregulloreje.
3. Komisioni shqyrton të gjitha aplikacionet dhe harton listën e kandidatëve, në të cilën përfshihen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 5 të kësaj rregulloreje. Kandidatët informohen brenda afatit prej 5 (pesë) ditësh dhe ftohen të marrin pjesë në fazat e tjera të procesit të përzgjedhjes.

4. KGJK, fillimisht, organizon provimin me shkrim për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 5 për secilin çift gjuhësh. Kandidatët, të cilët dëshirojnë të certifikohen për interpret, do të ftohen për provim me gojë, vetëm nëse e kanë kaluar me sukses provimin me shkrim.
5. Provimi mbahet në datën, kohën dhe vendin e përcaktuar nga KGJK-ja, respektivisht Komisioni.
6. Gjatë provimit, Komisioni vlerëson:
 - 6.1. zotësinë e përgjithshme të kandidatit për përkthim/interpretim në çiftin përkatës të gjuhëve; dhe
 - 6.2. njohuritë e terminologjisë juridike të kandidatit.

Neni 8

Komisioni

1. Provimi mbahet para Komisionit i cili zgjedhet nga lista e profesionistëve apo ekspertëve të gjuhës të miratuar nga KGJK.
2. KGJK krijon listën e profesionistëve apo ekspertëve gjuhësor përmes thirrjes së hapur për aplikim.
3. Komisioni për vlerësimin e kandidatëve për një çift gjuhësh përbëhet prej tre (3) anëtarësh, Një anëtar i Komisionit mund të jetë jurist apo gjyqtar.
4. KGJK harton dhe përditëson listën e personave që mund të jenë anëtarë të komisioneve për çifte gjuhësh.
5. Për t'u përfshirë në listën e KGJK-së, kandidati duhet të plotësojë njërin nga këto kushte:
 - 5.1. të jetë profesionist, apo të ketë ushtruar punën e përkthyesit në çiftin e gjuhëve jo më pak se pesë (5) vjet;
 - 5.2. të ushtojë profesionin e profesorit të gjuhës në të cilën kërkohet certifikimi jo më pak se pesë (5) vjet;
 - 5.3. juristi apo gjyqtari, i cili caktohet anëtar komisioni, duhet të jetë njohës i çiftit të gjuhëve për të cilat mbahet provimi; dhe
 - 5.4. të jetë përfaqësues i organizatave ndërkombëtare të cilat ofrojnë kurse në gjuhën përkatëse;

6. Anëtarët e Komisionit duhet të kenë njohuri për çiftin e gjuhëve të nivelit që mundëson vlerësimin e kandidatëve në atë çift gjuhësh.
7. Komisioni është përgjegjës për hartimin (formulimin e pyetjeve) të provimit me shkrim dhe me gojë. Pyetjet e parashtruara në provim janë konfidenciale dhe nuk guxojnë të ndahen me askënd jashtë Komisionit. Ndarja e testeve me persona jashtë Komisionit paraqet bazë për mos pagesë së punës së bërë në Komision si dhe bazë për tu larguar nga lista e anëtarëve të cilët mund të jenë pjesë e Komisionit.
8. Komisioni mbështetet nga sekretari i komisionit, që njëherit është udhëheqës i zyrës së përkthimeve i Sekretariatit të KGJK-së (këtu e tutje: SKGJK). Në rrethana të jashtëzakonshme, KGJK mund të caktojë një person tjetër për sekretar të komisionit.
9. Anëtarët e Komisionit kompensohen për punën e tyre, me përjashtim të anëtarëve nga radhët e shërbyesve civilë. Skema e kompensimit përcaktohet nga KGJK.

Neni 9

Përgjegjësitë e kryetarit dhe sekretarit të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit zgjedhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit.
 - 1.1. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për udhëheqjen e punës së Komisionit dhe: mbikëqyrë dhe miraton hartimin e provimit me shkrim dhe me gojë;
 - 1.2. ndërmerr masa dhe siguron që provimi të mbetet konfidencial deri në momentin e mbajtjes së provimit;
 - 1.3. mbikëqyrë dhe merr pjesë në kontrollimin e provimeve dhe rezultateve të provimit; dhe
 - 1.4. mbarëvajtjen e provimit.
2. Sekretari i Komisionit ka për detyrë:
 - 2.1. të verifikojë identitetin e personit i cili i nënshtrohet provimit;
 - 2.2. të njoftojë kandidatët për të drejtat dhe detyrat e tyre;
 - 2.3. të përpilojë raport për mbledhjet e Komisionit lidhur me rrjedhën e provimit i cili miratohet dhe nënshkruhet nga Komisioni; dhe
 - 2.4. të kryejë punë të tjera, sipas nevojës;

3. Sekretariati i KGJK-së mbështet Komisionin në punët e nevojshme logjistike dhe administrative për mbajtjen e provimit dhe certifikimin e kandidatëve.

Neni 10

Administrimi i provimit me shkrim

1. Në provim me shkrim ftohen të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe që kanë paraqitur kërkesë për t'u certifikuar për interpret dhe/ose përkthyes gjyqësor.
2. Para fillimit të provimit, zyrtarët e autorizuar, verifikojnë identitetin e kandidatit dhe i njoftojnë kandidatët lidhur me mënyrën e zhvillimit të provimit dhe u japin udhëzime rreth kodit sekret.
3. Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për provim ose nëse para fillimit të provimit deklaron se heq dorë, konsiderohet se ai nuk iu ka nënshtruar provimit.
4. Kandidati i cili heq dorë pasi që të ketë filluar provimin, konsiderohet se ka rënë nga provimi.
5. Nëse ka më shumë salla ku mbahet provimi, secila sallë do të jetë nën kontrollin e mbikëqyrësit të sallës i cili caktohet nga Sekretari i Komisionit. Detyrat e mbikëqyrësit të sallës janë drejtimi dhe kontrollimi i administrimit të provimit në sallën e caktuar. Mbikëqyrësi i sallës i raporton kryetarit të Komisionit.
6. Në vendin ku mbahet provimi, kandidatët duhet të ulen në vendin e caktuar nga mbikëqyrësi i sallës. Kandidatët të cilët vijnë në provim pas mbylljes së derës së sallës, nuk do të lejohen të hyjnë në provim.
7. Provimi me shkrim zgjat (2) dy orë. Gjatë provimit, kandidatit nuk i lejohet të ketë afër vetes asgjë përveç testit, fjalorit dhe stilolapsit. Shkelja e kësaj rregulle do të rezultojë me shpalljen e provimit si të pavlefshëm dhe diskualifikimin e kandidatit nga provimi.
8. KGJK do të ofrojë letër, stilolapsa dhe materialet apo pajisjet e nevojshme për mbajtjen e provimit.
9. Kur fillon provimi, të gjitha bisedat e kandidatëve ndërpriten dhe mbikëqyrësi i sallës lexon udhëzimet e provimit. Pas kësaj, mbikëqyrësi i sallës mund t'i përgjigjet pyetjeve të kandidatëve që kanë të bëjnë me udhëzimet.

10. Shpërndarja e testit, plikove dhe materialeve shtesë bëhen sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit të sallës.
11. Nuk lejohet shkrimi i emrit të kandidatit, shkrimi i numrave apo vendosja e ndonjë shenje tjetër dalluese në ndonjë prej fletëve të provimit. Në rast të veprimit të tillë, kandidati diskualifikohet.
12. Kandidatët nuk lejohen të dalin nga salla e provimit gjatë kohës së provimit. Përrjashtimisht, ata lejohen të dalin, por të shoqëruar nga mbikëqyrësit e provimit, po ashtu edhe kur e përfundojnë pjesën përkatëse të provimit dhe e mbyllin atë në pliko.
13. Kur të jepet shenja për përfundimin e provimit, kandidatët menjëherë vendosin testin në plikon e shpërndarë dhe e mbyllin atë. Në rast të kundërt, kandidati diskualifikohet nga provimi.
14. Në fund të provimit, kandidatëve u shpërndahet një pliko e vogël brenda të cilës ka një letër të vulosur ku kandidati duhet të shkruaj emrin dhe mbiemrin e tij dhe pastaj e mbyllë atë. Pliko e vogël, së bashku me plikon e madhe, në të cilën ndodhen testet, merret nga sekretari në përfundim të provimit.
15. Sekretari i Komisionit vendos një numër (kod sekret), i vulos ato dhe i vendosë në një pako të sigurt e cila gjithashtu vuloset. Pako e mbyllur dhe e vulosur ruhet në një vend të sigurt në KGJK dhe është nën mbikëqyrjen e sekretarit të Komisionit.
16. Komisioni pranon vetëm plikon e madhe në të cilën gjendet provimi me shkrim.

Neni 11

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve të provimit me shkrim

1. Provimet me shkrim i vlerëson Komisioni.
2. Provimi me shkrim mund të vlerësohet deri në njëqind (100) pikë. Nëse kandidati në provim arrin së paku shtatëdhjetë (70) pikë, konsiderohet se e ka kaluar provimin.
3. Çdo element i provimit me shkrim do të vlerësohet me pikët maksimale sipas këtyre kritereve:
 - 3.1. përkthimi nga gjuha A në gjuhën B 35 pikë;
 - 3.2. përkthimi nga gjuha B në gjuhën A 35 pikë;
 - 3.3. njohuritë e terminologjisë juridike 30 pikë.

4. Komisioni publikon listën e kandidatëve, që kanë kaluar provimin me shkrim në ueb faqen e KGJK-së, në afat prej 10 (dhjetë) ditësh, pas përfundimit të provimit me shkrim.

Neni 12 **Provimi me gojë**

1. Kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin me shkrim dhe dëshirojnë të certifikohen si interpret duhet t'i nënshtrohen provimit me gojë.
2. Vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit me gojë e cakton Komisioni shtatë (7) ditë pas publikimit të rezultateve të provimit me shkrim.
3. Provimi mbahet para Komisionit për atë çift gjuhësh në përputhje me rregullat e parapara në nenin 10 të kësaj rregulloreje.
4. Kandidatit, që nuk ka mundur të marrë pjesë në provim me gojë dhe këtë e vlerëson Komisioni të arsyeshme, provimi me shkrim do t'i mbetet i vlefshëm deri në afatin tjetër të provimit.

Neni 13 **Shpallja e rezultateve të provimit me gojë**

1. Provimi me gojë vlerësohet deri në njëqind (100) pikë. Konsiderohet se kandidati ka kaluar provimin nëse arrin së paku shtatëdhjetë (70) pikë.
2. Pas provimit me gojë, Komisioni e harton raportin e vlerësimit për secilin kandidat. Në raport përfshihen pikët e vlerësimit për kandidatin nga secili anëtar.
3. Komisioni publikon listën e kandidatëve të cilët e kanë kaluar provimin me gojë në ueb faqen e KGJK-së.

Neni 14 **Ankesa**

1. Kandidati i cili konsideron se rezultati i tij përfundimtar apo nga njëra pjesë e provimit nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë, mund të paraqesë ankesë në KGJK, në afat prej pesë (5) ditësh, pas publikimit të rezultateve. Kandidati, i cili e paraqet ankesën, ka të drejtë të shikojë provimin me shkrim apo raportin e vlerësimit me gojë në objektin e KGJK-së.

2. Për shqyrtimin e ankesave, KGJK themelon një Komision të Ankesave i cili shqyrton këto ankesa në afat prej 30 ditësh. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar.
3. Komisioni i Ankesave ka të drejtë të miratojë ose të refuzojë ankesën. Në rast të miratimit të ankesës, vendimi i Komisionit mund të anulohet dhe kandidatit i njihet kalueshmëria e provimit.
4. Procedura e ankimimit bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative.

Neni 15 Certifikata

1. Kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin me shkrim dhe me gojë, marrin certifikatë për dhënien e provimit për përkthyes, përkatësisht për të dyja, përkthyes dhe interpret gjyqësor.
2. KGJK lëshon certifikatën për kandidatët të cilët kanë dhënë provimin një (1) muaj pas publikimit të rezultateve.
3. Certifikata për dhënien e provimit përmban:
 - 3.1. logon e institucionit që lëshon certifikatën;
 - 3.2. numrin dhe datën kur është lëshuar certifikata;
 - 3.3. çiftin e gjuhëve për të cilën certifikohet;
 - 3.4. emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin;
 - 3.5. nënshkrimin e Kryesuesit të KGJK-së; dhe
 - 3.6. vulën zyrtare.

Neni 16 Kartela identifikuese dhe vula

1. Çdo interpret dhe përkthyes gjyqësor duhet të ketë kartelë dhe vulë. Shpenzimet për pajisje me kartelë dhe vulë i bartë vetë përkthyesi/interpreti gjyqësor. Format i kartelës dhe vulës përcaktohet nga KGJK-ja.
2. Vula duhet të jetë për çiftin e gjuhëve për të cilën është certifikuar.
3. Vula e cekur në paragrafin e mësipërm duhet të jetë e rrumbullakët, me diametër 40 mm, në të cilën duhet të shënohet:

- 3.1. në rrethin e parë: Republika e Kosovës / Republika Kosovo;
 - 3.2. në rrethin e dytë: përkthyes apo përkthyes dhe interpret gjyqësor; dhe
 - 3.3. në rrethin e tretë: emri dhe mbiemri i interpretit/përkthyesit;
 - 3.4. në rrethin e katërt: çiftin e gjuhëve për të cilën është i certifikuar.
4. Kartela e përkthyesit/interpretit duhet të përmbajë:
 - 4.1. logon e institucionit që e certifikon;
 - 4.2. numrin e certifikatës;
 - 4.3. emrin dhe mbiemrin; dhe
 - 4.4. çiftin e gjuhëve për të cilën është certifikuar;
 5. Kartela është e vlefshme vetëm kur vulozet nga KGJK-ja.
 6. Interpreti/përkthyesi duhet ta deponojë nënshkrimin dhe kopjen e vulës në KGJK. Përshtatshmërisht kur të krijohen kushtet, përkthyesit dhe interpretët mund të deponojnë nënshkrimin dhe vulën elektronike.
 7. Përmbajtja e tekstit standard që vërteton saktësinë e përkthimit sigurohet nga KGJK-ja për të gjithë përkthyesit gjyqësorë të certifikuar.

Neni 17

Regjistri

1. Interpretët dhe/apo përkthyesit gjyqësorë regjistrohen në Regjistrin e interpretëve dhe përkthyesve të certifikuar nga KGJK-ja (në tekstin e mëtejme: Regjistri).
2. Regjistri i interpretëve dhe përkthyesve të certifikuar përmban të gjitha informatat kontaktuese dhe informatat e tjera rreth interpretëve dhe përkthyesve të certifikuar gjyqësorë.
3. Regjistri specifikon çiftin e gjuhëve për të cilin përkthyesi apo/dhe interpreti i certifikuar është kompetent.
4. Përkthyesit dhe interpretët e certifikuar duhet ta njoftojnë menjëherë KGJK-në për çdo ndryshim të të dhënave të përfshira në Regjistrë.
5. Regjistri publikohet në ueb faqen e KGJK-së dhe në gazetën zyrtare.
6. Regjistri administrohet nga SKGJK-ja.

Neni 18

Shlyerja nga Regjistri

1. Përkthyesi apo/dhe interpreti fshihet nga Regjistri për arsye në vijim:
 - 1.1. me kërkesën e tij;
 - 1.2. në rast të vdekjes;
 - 1.3. në rast të humbjes së zotësisë së veprimit;
 - 1.4. në rast të revokimit të certifikatës.
2. Certifikata revokohet në rastet si në vijim:
 - 2.1. nëse nuk kanë ekzistuar ose kanë pushuar së ekzistuari kushtet në bazë të të cilave përkthyesi apo interpreti është certifikuar;
 - 2.2. nëse është dënuar për veprë penale në përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 2.3. nëse në mënyrë të pandërgjegjshme, të pa rregullt dhe jo profesionale e kryen punën. Interpreti/përkthyesi, konsiderohet se punën e tij/saj e kryen në mënyrë të parregullt dhe joadekuate nëse:
 - 2.3.1. refuzon pa arsye të interpretojë/përkthejë;
 - 2.3.2. pa arsye nuk iu përgjigjet ftesave të gjykatës, më tepër se tri herë me ndërprerje dhe pandërprerë dhe lidhur me këtë nuk ofron arsyetim të justifikueshëm në momentin kur ftohet;
 - 2.3.3. kur interpreti e konfirmon pjesëmarrjen në seancë dhe nuk paraqitet pa e njoftuar me kohë organin/gjykatën e cila e ka ftuar; dhe
 - 2.3.4. pa arsye nuk e përfundon interpretimin/përkthimin në kohën e caktuar nga gjykata.
3. Përkthyesi ftohet në momentin kur ftohen edhe palët tjera në procedurë përveç në rastet e karakterit urgjent.
4. Vendimin për shlyerje nga regjistri e merr shefi/ja e Zyrës së Përkthimeve në SKGJK.

Neni 19

Rishikimi i vendimit

1. Përkthyesi/interpreti mund të kërkojë rishikim të vendimit për heqje nga Regjistri në KGJK, përkatësisht revokim, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi ta ketë pranuar njoftimin mbi

vendimin. Kundër vendimit mund të paraqitet ankesë tek Komisioni i Ankesave, i themeluar nga KGJK.

2. Nëse është e nevojshme, Komisioni i ankesave heton faktet dhe rrethanat që formojnë bazën e kërkesës.
3. Komisioni i Ankesave, në bazë të gjetjeve, vendos lidhur me kërkesën.

Neni 20

Skema e kompensimit

1. Përthyesit, respektivisht interpretët gjyqësorë do të kompensohen për shërbimet e dhëna sipas skemës së përcaktuar në këtë nen.
 - 1.1. Për përkthimin e dokumenteve nga një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës në një gjuhë të huaj dhe anasjelltas do të llogaritet çmimi prej 0.03 € për çdo fjalë të përkthyer.
 - 1.2. Për verifikim të përkthimit, që ka bërë një person tjetër, përkthyesit gjyqësor i takon gjysma e kompensimit nga paragrafi 1.1 i këtij neni.
2. Për interpretimin nga një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës në një gjuhë të huaj dhe anasjelltas, si dhe për interpretim nga një gjuhë e huaj në tjetrën:
 - 2.1. për një orë interpretimi - 25.00 €
 - 2.2. për orën e filluar - 15.00 € (deri në 30 minuta), duke llogaritur kohën e humbur për të ardhur dhe kthyer në vendin ku është kërkuar përkthimi.
3. Në kohën e llogaritur për interpretim, përfshihet koha e kaluar në vajtje-ardhje të interpretit. Llogaritja bëhet si në vijim:
 - 3.1. deri në 20 km vajtje-ardhje: pa kompensim;
 - 3.2. prej 21– 60 km vajtje-ardhje: 1 orë;
 - 3.3. prej 61 – 100 km vajtje-ardhje: 2 orë; dhe
 - 3.4. prej 101 – 200 km vajtje-ardhje: 3 orë.
4. Për punën të cilën përkthyesi apo interpreti, me kërkesë të palës apo në raste urgjente, e kryen jashtë orarit të përcaktuar të punës apo në ditët e fundjavës dhe të festave, kompensohet në bazë të nenit 56 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

Neni 21

Çifti i gjuhëve që nuk janë mbuluar

1. Në raste të jashtëzakonshme kur, në regjistrin e përkthyesëve apo interpretëve gjyqësorë, nuk ka përkthyes apo interpret gjyqësorë të certifikuar, për atë çift gjuhësh, gjykata apo institucioni

përkatës mund të angazhojë përkthyes apo interpret gjyqësor të jashtëm apo njohës të gjuhës i/e cila/i nuk është i certifikuar.

2. Përshtimisht, në raste të veçanta, gjykatat mund të angazhojnë përkthyes të pacertifikuar nga KGJK kur ajo gjuhë nuk është gjuhë për të cilën është kërkuar përkthyes apo interpret gjuhësor më parë. Para angazhimit të përkthyesit, gjykata e kërkon ndihmën e KGJK-së për të identifikuar apo angazhuar përkthyesin.
3. Këshilli Gjyqësor e mban/rezervon të drejtën për kërkimin e ndihmës nga autoritetet kompetente të shteteve tjera për sigurimin e përkthyesve në gjuhën përkatëse.

Neni 22

Kodi i Etikës për përkthyes dhe interpret gjyqësor

1. Të gjithë përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë janë të obliguar t'i përmbahen Kodit të Etikës për përkthyes dhe interpret gjyqësor të paraqitur në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
2. Shkelja e Kodit të Etikës paraqet bazë për revokimin e certifikatës dhe heqjes nga regjistri.

Neni 23

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me certifikimin e përkthyesve/interpretëve të rinj, ftohen të gjithë përkthyesit dhe interpretët e certifikuar me aktvendim nga ish gjykatat e qarkut, në mënyrë që të paraqiten në KGJK për përfshirjen e tyre në listën e re të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë.
2. Përkthyesit me aktvendime nga ish gjykatat e qarkut janë të obliguar të pajisen me certifikatë dhe kartelë siç parashihet me këtë rregullore. Shpenzimet rreth pajisjes me kartelë i mbulon vet përkthyesi/interpreti.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen Rregullorja nr.16/2015 për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësorë dhe Rregullorja Nr. 16/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.16/2015 për Emërimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësorë.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli



Skeuder Coçaj

Prishtinë, më datë 17.09.2019

Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Kodi i Etikës për përkthyes dhe interpret gjyqësor

Preambulë:

Shumë persona që dalin para gjykatave nuk janë folës burimorë apo të rrjedhshëm të të dyja apo njëres gjuhë zyrtare të Kosovës. Funkzioni i interpretëve dhe përkthyesve të certifikuar gjyqësorë është që ta heqin barrierën gjuhësore, për aq sa është e mundur, në mënyrë që personat e tillë të kenë qasje të njëjtë në drejtësi sikurse folësit burimorë apo të rrjedhshëm për të cilët nuk ekzistojnë barrierë të tilla. Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë luajnë rol thelbësor në të gjitha përpjekjet për ta siguruar barazinë e qytetarëve në procedurat dhe proceset gjyqësore. Shkalla e besimit që u jepet interpretëve dhe përkthyesve gjyqësorë dhe përgjegjësia e madhe që kanë ata kërkojnë standarde të larta dhe të njëjta etike që edhe do ta udhëzojnë, edhe do ta mbrojnë gjykatën.

Zbatimi:

Të gjithë përkthyesit dhe interpretët e certifikuar dhe të regjistruar janë të obliguar që ta zbatojnë këtë Kod.

Rregullat:

Rregulla 1. Saktësia e gjuhës burimore: Të gjitha fjalët duhet të përkthehen besnikërisht në gjuhën e përkthimit, duke i ruajtur të gjitha elementet e mesazhit origjinal dhe duke i përdorur format sintaksore dhe semantike të gjuhës së përkthimit. Përkthimi duhet të tingëllojë i natyreshëm në gjuhën e përkthimit, ndërsa mesazhi origjinal nuk duhet të shtrembërohet përmes shtimeve apo heqjeve, shpjegimeve apo parafrazimeve.

Të gjitha elementet e pa thëna, siç janë pauzat, gabimet, fillimet e gabueshme dhe/ose përsëritjet duhet të barten në gjuhën e përkthimit. Fjalët e gjuhëve të huaja të cilat nuk kanë përkthim adekuat në gjuhën shqipe, duhet të ruhen sikurse edhe shprehjet që kanë të bëjë me kulturën dhe që nuk kanë ndonjë shprehje ekuivalente të drejtpërdrejtë në gjuhën e përkthimit, ose që mund të kenë më shumë se një kuptim.

Regjistri, stili dhe toni i gjuhës burimore duhet të ruhen. Duhet të shmangët supozimi.

Interpretët gjyqësorë, që nuk dëgjojnë apo nuk kuptojnë se çfarë ka thënë folësi, duhet të kërkojnë sqarime menjëherë. Gabimet e përkthyesit/es duhet të korrigjohen për procesverbal sa më parë që të jetë e mundur.

Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë do ta përdorin teknikën specifike të përkthimit (përkthimin konsektiv, simultan, pëshpëritës, gjatë të lexuarit) sipas kërkesave për komunikim optimal ndërkulturor në kontekstin juridik.

Rregulla 2. Paanshmëria dhe konfliktet e interesit: Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë duhet të mbesin të paanshëm dhe neutralë në të gjitha procedurat gjatë të cilave shërbejnë, ndërsa duhet ta ruajnë edhe përshtypjen e paanshmërisë dhe neutralitetit. Nga interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë kërkohet që t'i shmangen kontaktit me palët, me dëshmitarët dhe cilindo ushtrues të ndonjë profesioni juridik dhe/ose familjar apo mik të tyre.

Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë abstenojnë nga komentimi për rastet në të cilat shërbejnë.

Çdo konflikt real apo potencial i bëhet me dije menjëherë gjykatës dhe të gjitha palëve sapo interpreti/ja apo përkthyesi/ja të vihet në dijeni për ndonjë konflikt të tillë të interesit.

Interpreti dhe përkthyesi gjyqësor, që ka statusin e zyrtarit publik, duhet ta informojë paraprakisht mbikëqyrësin e tij dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për çdo veprimtari që kryen me pagesë, jashtë detyrës së tij, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rregulla 3. Konfidencialiteti: Interpreti/ja nuk i zbulon informatat e privileguara ose konfidenciale që i merr gjatë interpretimit ose përgatitjes për përkthim, pa autorizimin e drejtpërdrejtë dhe me shkrim të gjykatës, ndërsa të gjithë interpretët u nënshtrohen kushteve të Marrëveshjes së Konfidencialitetit, që e nënshkruajnë në kohën e certifikimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë përmbahen nga përfitimi i çfarëdo dobie personale apo financiare nga informatat që i marrin gjatë një detyre të interpretimit ose përkthimit gjyqësor apo gjatë përgatitjes për të.

Rregulla 4. Kufizimet në praktikë: Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në çështjet në të cilat shërbejnë me interpretim dhe përkthim. Palëve nuk u ofrojnë këshilla dhe nuk përfshihen në aktivitete që mund të interpretohen si praktikim i ligjit ose avokim në emër të cilëso palë. Çdo kërkesë bërë interpretit/es ose përkthyesit/es për ta bërë këtë duhet t'i bëhet me dije gjykatës menjëherë.

Rregulla 5. Protokoli dhe shkeljet: Interpretët gjyqësorë sillen në përputhje me standardet profesionale dhe protokollet e gjykatës. Ata sillen me dinjitet dhe respekt ndaj gjykatës dhe i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë sa më diskrete që të jetë e mundur. Interpretët gjyqësorë duhet t'i përdorin vetat gramatikore si folës. Kur bëhet e domosdoshme që të marrin rol parësor në

komunikim, nga ta kërkohet që të deklarohen se janë duke folur për vetveten duke e përdorur veten e tretë si instancë (p.sh.: "Interpreti ka nevojë që të kërkojë sqarim...")

Rregulla 6. Ruajtja dhe përmirësimi i shkathtësive dhe njohurve: Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë përpiqen t'i ruajnë dhe përmirësojnë shkathtësitë dhe njohuritë e tyre të interpretimit dhe përkthimit dhe të kuptojnë se nga ta mund të kërkohen prova për aktivitetet e tilla gjatë ndonjë procesi të ricertifikimit.

Rregulla 7. Paraqitja e saktë e kredencialeve: Për tu certifikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë, përmes sigurimit të kopjeve të certifikuara dhe zyrtare, në mënyrë të saktë, i paraqesin certifikatat, akreditimet, trajnimet dhe përvojën relevante.

Rregulla 8. Pengesat në zbatim: Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë menjëherë ia bëjnë me dije gjykatës çdo rrethanë ose kusht që e pengon zbatimin e plotë të çdo rregulle të këtij Kodi, përfshirë lodhjen e interpretit/es, pamundësinë për të dëgjuar ose mungesën e njohurive të duhura për terminologjinë e veçantë dhe/ose të kuptuarit e pamjaftueshëm të ndonjë dialekti.

Interpretët dhe përkthyesit gjyqësorë nuk duhet ta pranojnë ndonjë detyrë për të cilën nuk kanë zotësi adekuate (në kuptim të gjuhës apo lëndës) apo të cilën nuk janë në gjendje ta kryejnë në mënyrën e duhur (p.sh. për shkak të kohës së pamjaftueshme për tu përgatitur për atë detyrë). Ata duhet t'i refuzojnë detyrat që duhet të kryhen në kushte që e bëjnë të pamundur performancën e një profesionisti të kualifikuar.

Burimet dhe parimet kryesore:

Kodi i Etikës për Interpretë dhe Përkthyes Gjyqësorë të certifikuar buron drejtpërsëdrejti nga parimet që janë përkufizuar në burimet në vijim. Ato e demonstrojnë rolin kyç të interpretëve dhe përkthyesve gjyqësorë në kërkimin e së vërtetës dhe mënyrën se si puna e tyre mund të ndikojë në jetën dhe të drejtat e të tjerëve:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, dhjetor 1948 (nenet 1-11),

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, nëntor 1950 (nenet 5 dhe 6) •,

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (2000/C 364/01), KAPITULLI III – nenet 20 – 21, KAPITULLI VI –nenet 47 – 50,

Direktiva 2010/64/EU e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e 20 tetorit të vitit 2010 për të Drejtën në Interpretim dhe Përkthim në Procedurë Penale.

Përkufizimi i termave

Për qëllimet e këtij Kodi, termat në vijim do t'i kenë këto kuptime:

Gjuhët zyrtare: Ato gjuhë që janë përkufizuar në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve (02/L-37) me theks të veçantë në nenet 2, 12, 13, 14, 16 dhe 17.

Interpret/e dhe/ose përkthyes/e gjyqësor/e: Interpretët dhe/ose përkthyesit gjyqësorë janë profesionistë që janë të kualifikuar për ta përkthyer gjuhën e folur dhe/ose gjuhën e shkruar dhe që janë certifikuar për ta bërë këtë në gjykatat e Kosovës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për gjuhët specifike.

Përkthimi konsektiv: Interpreti përkthen pasi folësi i gjuhës burimore ta ketë kryer të folurit. Përkthyesit e gjuhës së folur mund të përdorin teknika të veçanta të marrjes së shënimeve për të ndihmuar në përkthimin e fjalive të gjata.

Zotësia ndërkulturore: Vetëdija profesionale dhe të kuptuarit e faktorëve kulturorë, duke përfshirë sjelljen dhe gjestet, tonin e zërit, vlerat, rolet, institucionet si dhe dallimet dhe ngjashmëritë gjuhësore, por duke mos u kufizuar me to.

Përkthimi simultan: Interpreti e bart mesazhin nga gjuha burimore në gjuhën e përkthimit dhe anasjelltas.

Përkthimi gjatë të lexuarit: Kjo metodë kërkohet për përkthimin me gojë të dokumenteve të shkruara sipas rastit. Dokumenti në gjuhën burimore përkthehet me gojë.

Pëshpëritja: Përkthim simultan, pa përdorimin e kabinave të përkthimit, i cili zakonisht u ofrohet më së shumti tre personave.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Deklarata e pranimit

Unë, _____ pranoj se më është siguruar një kopje e “Kodit të Etikës për Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor” dhe se e kam lexuar dhe e kuptoj fushëveprimin e plotë të Kodit dhe zbatimin e tij për punën time si përkthyes/e ose interpret/e gjyqësor/e i/e certifikuar. Përveç kësaj, unë e pranoj se e kuptoj se do të mbaj përgjegjësi për të gjitha rregullat që i përmban Kodi dhe se për shkeljen e cilësdo rregull do t’i nënshtrohem procedurës disiplinore, duke përfshirë anulimin e certifikimit tim dhe ndalimin e aftësisë sime për të marrë dhe për të pranuar detyra si interpret/e dhe/ose përkthyes/e gjyqësor/e.

Kjo deklaratë e pranimit do të ruhet si pjesë e dosjes së certifikimit tim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Unë e kuptoj se, nëse Kodi përditësohet apo ndryshohet në çfarëdo mënyre, nga unë do të kërkohet që ta nënshkruaj një deklaratë të re të pranimit të Kodit të ri për ta ruajtur certifikimin tim.

Emri dhe mbiemri: _____

Numri i letërnjoftimit: _____

Nënshkrimi dhe data: _____